

Bashkia: FIER

Kryetar: ARMANDO SUBASHI

Fusha: INFRASTRUKTURË DHE SHËRBIME PUBLIKE

Premtime:

1. Stacioni i trenit do të kthehet në terminal modern të autobuzëve
2. Do të ndërtohet spitali rajonal i Fierit
3. Do të hartohet Plani i Përgjithshëm Vendor, përcaktimi i kufirit të zgjerimit të qendrave të banuara përmes studimeve të detajuara dhe hapja rrugë dhënies së lejeve të ndërtimit
4. Do të kryhet konkurs ndërkombëtar për projektin e zhvillimit të qendrës së bashkisë
5. Do të kryhet rikonstruksion me parametra bashkëkohor të rrugëve që lidhin qendrën e bashkisë me qendrat e banuara
6. Do të kryhet zhvillimi i projekteve të infrastrukturës rrugore që lidh qendrën e Bashkisë me Parkun Arkeologjik të Apolonisë, me spitalin Rajonal Fier dhe Parkun e Gjelbër
7. Do të kryhet hartimi i një zone të re rezidenciale në pjesën kodrinore, jugperindimore të Fierit
8. Do të kryhet lirimi i çdo hapësire publike të zaptuar në bazë të ligjit dhe kthimi i tyre tek qytetarët, si hapësirë e "të gjithëve" dhe "për të gjithë", përmes projekteve të ripërtëritjes urbane
9. Do të fillojë studimi i fizibilitetit për ndërtimin e një miniporti dhe përcaktimin e një zone industriale në Seman, si pikë fundore e TAP-it
10. Do të kryhet finalizimi i fazës së 3-të të projektit të ujësjellësit në territorin e bashkisë
11. Do të kryhet përfundimi i "Unazës Perëndimore"
12. Do të kryhet rruga "Aulona" (Rruga e Vlorës)
13. Do të kryhet ripërtëritje urbane e bulevardit "Ramiz Aranitasi" (Teatri Bylis - QTU)
14. Do të kryhet rruga "Mujo Ulqinaku" (nga Sharra tek "M. Dashi")
15. Do të kryhet pedonalja "Leon Rei" (rruga e Muzeut Historik)
16. Do të kryhet rruga "Rauf Nallbani" (rruga e Stacionit të Trenit)
17. Do të kryhet kanalizimi i ujërave të zeza dhe ujit të pijshëm në lagjen 16 Prilli
18. Do të kryhet asfaltimi i rrugës, trotuarë, ndriçim dhe gjelbërim në lagjen 16 Prilli
19. Do të çlirohen të gjitha hapësirat publike që janë zënë në lagjen 16 Prilli
20. Do të punohet për ndërtimin e një minikëndi sportiv në lagjen 16 Prilli
21. Do të kryhet rruga Fier - Kallm
22. Do të kryhet infrastruktura tokësore dhe nëntokësore në lagjen "Afrim"
23. Do të shtrihet rrjeti i kanalizimit të ujërave të zeza dhe të bardha dhe do të rikonstruktohet infrastruktura rrugore në lagjen "Sheq i Madh" (1,3 miliard lekë)
24. Do të kryhet kanalizimi i ujërave të zeza dhe të bardha, asfaltim dhe rikonstruksion i infrastrukturës rrugore dhe sistemimi i telave të korentit në lagjen "15 Tetori"
25. Do të kryhet rruga Fier - Mujalli
26. Do të kryhet rruga Fier - Ndërnënas - Hasturkas - Bregdet

27. Do të kryhet rruga Fier - Kallm i Mash - Kallm i Vogël - Belinë
28. Do të kryhen kanalizime KUZ dhe KUB në zonën informale të Afrimit
29. Do të urbanizohet zona informale në lagjen Mbrostar Ferko
30. Do të kryhen kanalizime KUZ dhe KUB në Mbrostar Ferkos
31. Do të rikonstruohet rruga e Ndërnënas
32. Do të zgjidhet problemi i tokave në fshatin Grecalli
33. Do të zgjidhen problematikat në infrastrukturë në nj. ad. Qendër
34. Do të çohen shërbimet publike në çdo fshat, në çdo familje, tek çdo fermer në nj. ad. Qendër
35. Do të rikonstruohet rruga Levan - Shtyllas
36. Do të rikonstruohet rruga e Bishanit
37. Do të zgjidhet problemi i tokave në fshatin Shtyllas

Fusha: ARSIM/KULTURË/SPORT

Premtime:

1. Do të investohet në terrene sportive për masivizimin e sporteve në territorin e bashkisë
2. Do të kryhet ndërtimi dhe rikonstruksioni i çerdheve në territorin e bashkisë
3. Do të kryhet ndërtimi dhe rikonstruksioni i kopshteve në territorin e bashkisë
4. Do të kryhet ndërtimi dhe rikonstruksioni i shkollave në territorin e bashkisë
5. Do të kryhet lirimi i oborreve të shkollave nga ndërtimet pa leje në territorin e bashkisë
6. Do të kryhet ndërtimi i terreneve sportive dhe kthimi i tyre në qendra komunitare në territorin e bashkisë
7. Do të kryhet promovimi i Apollonisë, Bylisit, Manastirit të Ardenicës, Gurët e Zezë në Cakra, Kisha e Vjetër e Kujanit si një paketë e vetme turistike
8. Do të kryhet masivizim i të gjitha llojeve të sporteve në territorin e bashkisë
9. Do të kryhet restaurim i të gjitha objekteve dhe ndërtimeve të trashëgimisë
10. Do të kryhet rikonstruksion i plotë i Teatrit "Bylis"
11. Do të shpallet kalendari artistik vjetor që në janar
12. Do të kryhet riaktivizim dhe rikonstruksion i Teatrit të Kukullave, Shtëpive të Kulturës në çdo qendër të banuar
13. Do të kryhet kthimi i Shkollës Rajonale Artistike "Jakov Xoxa" në epiqendër të aktiviteteve artistike
14. Do të kryhen aktivitete kulturore lëvizëse në të gjitha qendrat e banuara në shërbim të komunitetit
15. Do të kryhet stimulim dhe vlerësim i figurave të shquara të trevës, në fushat e artit, kulturës dhe historisë
16. Do të kryhet zgjerim i pjesëmarrjes së aplikimit në programet ndërkombëtare për rritjen e kapaciteteve absorbuese financiare
17. Do të kryhet përfundimi i projekteve infrastrukturore - sportive të nisura (Kompleksi sportiv pranë ETC, Qendra e sporteve të rënda)
18. Do të kryhet ndërtimi i kompleksit stërvitor në Darzezë për fazat përgatitore dhe ngritjen e një kompleksi të dytë në zonat malore

19. Do të kryhet transformim i sh.a i të gjitha klubeve dhe shoqatave sportive, me qëllim rritjen e financimit dhe miradministrimit të tyre
20. Do të arrihet renditja ndër ekipet më të mira të Superligës për F.K. "Apollonia" dhe shtimi i numrit të aksionerëve, me qëllim rritjen e financimeve
21. Do të kryhet rritja e buxhetit për sportin
22. Do të kryhet rehabilitim i terreneve sportive dhe palestrave në të gjitha shkollat, qendrat e komunave dhe qytet

Fusha: MJEDIS/TURIZËM

Premtime:

1. Do të ndërtohen impiante për pastrimin e të gjitha ujërave që derdhen në det në territorin e bashkisë
2. Do të prishen ndërtimet pa leje në zonën e Gjanicës, shpronësimi i atyre me leje, pastrimi, sistemimi i lumti Gjanica dhe krijimi i mjediseve çlodhëse në këtë zonë

Fusha: BUJQËSI

Premtime:

1. Do të ndërtohen tregje, me fondet e bashkisë, për shitjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale me shumicë dhe pakicë në territorin e bashkisë
2. Do të ngrihen sistemet e vaditjes dhe kullimit në territorin e bashkisë
3. Brenda mandatit qeverisës, do t'u jepet të gjithë fermerëve të Bashkisë së re, çertifikata e pronësisë mbi tokën
4. Do të mbyllet porçesi i azhornimit të tokave bujqësore
5. Do të ngrihen pika grumbulli të produkteve të zonës me shumicë dhe frigoriferike në territorin e bashkisë
6. Do të kryhet nxitja dhe krijimi i ndërmarrjeve agro-përpunuese
7. Do të kryhet unifikimi i informacionit dhe krijimi i sistemit të administrimit të tokës
8. Do të kryhet taksim i diferencuar për tokën dhe këto të ardhura do të kthehen 100% me investime për tokën
9. Do të kryhet kontroll i cilësisë së inpueteve bujqësore dhe dhënie informacioni falas fermerëve
10. Do të stimulohet krijimi i fermave minimumi 5 ha
11. Do të kryhet stimulim i procesit të konsolidimit të kulturave bujqësore
12. Do të ndiqen politika për subvencionimin e fermerëve në tokat kripore
13. Do të kryhet azhornimi i tokave me kosto zero, gjë e cila do t'i japë fund problemeve që kanë fermerët e nj. ad. Mbrostar
14. Do të kryhet pastrimi dhe rregulli i të gjitha veprave bonifikuese në fshatin Shtyllas
15. Do të rriten të ardhurat e familjes pasi do të ndërtohen tregje për shitjen e prodhimeve në njësinë administrative Portëz
16. Do të kryhet vaditja dhe kullimi i tokave bujqësore me veprat bonifikuese në nj. ad. Portëz

Fusha: TRANSPARENCA

Premtime:

Fusha: SHËRBIMET SOCIALE

Premtime:

1. Komuniteti rom do të ketë një përfaqësues në Këshillin Bashkiak
2. Do të ngrihet një grup pune në bashki për regjistrimin e komunitetit rom
3. Një prej tregjeve që do të ngrihet në bashki do të jetë i dedikuar për produktet e komunitetit rom
4. Një prej nën kryetarëve të bashkisë do të jetë nga personat me aftësi të kufizuar

Fusha: EKONOMI DHE PUNËSIM

Premtime:

1. Do të shtohet administrata e re e bashkisë me studentët e rinjë që po mbarojnë studimet apo që sapo kanë përfunduar studimet
2. Do të punësohen në administratën e bashkisë persona me aftësi të kufizuar
3. Do të kryhet krijimi i Këshillit Ekonomik, si një forum bashkëpunimi mes biznesit dhe pushtetit lokal
4. Do të kryhet përjashtim nga taksa e ndikimit në infrastrukturë e investitorëve që do të investojnë në zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë (me vlerë investimi mbi 200000 EURO)
5. Do të nxitet hapja e fasonerive me mbi 100 punonjës dhe vënia në dispozicion të tyre pa qira e ambienteve në pronësi të bashkisë Fier
6. Do të ngrihet një zyrë në bashki që do të ofrojë shërbime për: *Informim dhe trajnim të fermerëve për skemat ekzistuese të financimit; Ndërmjetësim falas tek institucionet financiare të mikrokredisë; Informacion për real estate (shitje, blerje, dhënie me qera të tokave bujqësore)*
7. Do të kryhet thjeshtim i procedurave të taksimit dhe aplikimit për leje e liçensa